



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE**

**SHPLLJE PËR NJË VËND TË LIRË PUNE PËR KATEGORINË E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS-PUNËTOR PASTRIMI**

Në zbatim të nenit 12, të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shpall procedurën e plotësimit të vëndit të lirë të punës në kategorinë punonjës mbështetës:

1(një) punonjës të pastrimit me kontratë pune në Drejtorinë e Shërbimeve dhe të Mirë Mirëmbajtjes në administratën e Gjykatës Kushtetuese.

Vëndi i punës më sipër u ofrohet të gjithë kandidatëve që plotësojnë kërkesat e kategorisë së punonjësve mbështetës për punëtor pastrimi.

Data e fillimit të njoftimit:

11 mars-2019

Data e mbarimit të njoftimit:

18 mars-2019

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave:

18 mars-2019

Përshkrimi përgjithësues i punës për kategorinë e punonjësve mbështetës si më sipër është:

Vendi i punës “Punonjës Mirëmbajtës teknik”, kërkon:

1) Qëllimi i pozicionit të punës:

Të mbajë të pastër dhe të mirëmbajë ambientet e Gjykatës Kushtetuese në funksion të veprimtarisë normale të institucionit.

2) Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Te pastroje dhe mirëmbaje me cilesi dhe ne kohe zyrat dhe mjediset qe i jane ngarkuar sipas ndarjes së punës të bërë nga eprori i drejtorisë për shërbimet dhe mirëmbajtjen në Gjykatën Kushtetuese.
- Te njoftoje per çdo parregullsi apo problem ne zyrat dhe mjediset e tjera qe i jane ngarkuar te pastroje dhe mirëmbajë dhe të njoftojë menjëherë eprorin e saj/tij.
- Te administroje me rregull dhe me korrektësi pajisjet që ka në inventar dhe në përdorim.
- Te terheqe nga magazina detergjentet dhe mjetet e tjera te punes sipas nevojës me urdher dorezimi.
- Te miradministroje materialet dhe detergjentet që tërheq nga magazina.
- Te kryeje cdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga eprori i saj/tij qe kane te bejne me mirembajtjen e pastërtinë e zyrave e ambienteve të gjykatës.

3) **Marrëdhëniet organizative**

Punonjesi/ja i/e pastrimit ka varesi te drejtperdrejte nga Drejtori i Sherbimit te Mirembajtjes. Ai/ajo gjithashtu raporton sipas kerkeses tek Drejtori i Sherbimeve dhe Mirëmbajtjes.

4) **Kërkesat e vëndit të punës**

- Të ketë arsimin e mesëm.
- Të ketë përvojë pune 3 vjet e lart.
- Te kete nje figure te paster morale.
- Te mos jete i/e denuar me vendim te formes se prere te gjykates.
- Te kete aftesi te mira komunikimi.
- Te jete i/e gatshme te punoje jashte orarit (kur eshte e nevojshme).

5) **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26, Tiranë, dokumentat e mëposhtme:

- Kërkesën për aplikim;
- Curriculum Vitae të përditësuar me datën dhe firmën e personit;
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Vërtetim papunësie lëshuar nga Zyra e Punës ose fotokopje e librezës së punës në rast se është i papunë;
- Vlerësim të punës nga punëdhënësi i fundit;
- Vërtetimin e banimit të lëshuar nga zyra e gjendjes civile përkatëse;
- Fotokopje e diplomës së Shkollës së Mesme;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Vërtetimi i gjëndjes gjyqësore ose formulari i plotësuar per lejimin e kontrollit të gjëndjes gjyqësore në mënyrë elektronike nga institucioni;
- Vërtetim të gjëndjes shëndetsore(raport mjeko-ligjor nga komisioni i qëndrës ku banon)

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brënda datës 18.03.2019.

6) **Mënyra e vlerësimit dhe përzgjedhja të kandidatëve**

- **Faza e parë e seleksionimit do të bëhet nëpërmjet dokumentave nga DEkBNj-ja.**
- **Faza e dytë me një intervistë të thjeshtë.**

- ÷ Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i brendshëm”, i ngritur pranë instancionit të Gjykatës Kushtetuese. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 60 pikë për dokumentacionin dhe 40 pikë për intervistën me gojë.
- ÷ Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojat e punës, si dhe vlerësimet pozitive sipas dokumentacionit të dorëzuar i ndarë si më poshtë:
 - 10 pikë jetëshkrimi;
 - 10 pikë për eksperiencën e përgjithshme;
 - 20 pikë për përvojën në administratën shtetërore;
 - 20 pikë për vlerësimet pozitive.
- ÷ Kandidatët për intervistën me gojë do të vlerësohen me 40 pikë në lidhje me:
 - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e vendit të punës;
 - Përvojën e tyre të mëparshme;
 - Njohuritë e përgjithshme për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese;
 - Njohuritë e përgjithshme për Kodin e punës;
 - Njohuritë për Rregulloren e Brëndshme të Gjykatës Kushtetuese;
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit 4 2243 698 ose në adresën: Gjykata Kushtetuese, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26, Tiranë.

GJYKATA KUSHTETUESE

Tirane, me, 11.03.2019